



## **ODA E INFERMIERËVE, MAMIVE DHE PROFESIONISTËVE TË TJERË SHËNDËTËSORE TË KOSOVËS**

---

### **Kodi Etik**

#### **i Infermierëve, Mamive dhe Profesionistëve të tjerë Shëndetësor të Kosovës**

#### **Neni 1**

#### **Hyrje**

Me Kodin Etik të Infermierëve, Mamive dhe Profesionistëve të tjerë Shëndetësor, përcaktohen parimet bazë të sjelljes profesionale, raporti me pacientët, bashkëpunimi me ekip të kujdesit shëndetësor, respektimi i fshehtësisë profesionale, edukimi i vazhdueshëm profesional, mbrojtja e pacienteve nga rreziku, si dhe përgjegjësitë që kanë të bëjnë me çështje etike dhe marrëdhëniet me Infermier, Mami dhe Profesionit të tjerë shëndetësor.

#### **Neni 2**

#### **Parimet themelore**

Parimet bazë të sjelljes profesionale të Infermiereve, Mamive dhe Profesionistëve të tjerë Shëndetësor:

Infermierët duhet:

- Të respektojnë pacientin si qenie njerëzore!
- Të respektojnë të drejtat e pacienteve, integritetin e tyre fizik dhe mendor.
- Të respektojnë personalitetin dhe privatësinë e pacientit.
- Të respektojnë botëkuptimet dhe besimet fetare të pacientit.

- Të sigurohet që pacienti ka dhënë pëlqimin e tij para kryerjes së çfarëdo shërbimi dhe kujdesi shëndetësor ndaj tij/saj.
- Të ruaj fshehtësinë profesionale.
- Të bashkëpunoj me anëtarët tjerë të ekipit.
- Të ruaj dhe avancoj njohuritë dhe aftësitë e saj/tij profesionale.
- Të jetë një person i besueshëm.
- Të veproj për të njohur rrezikun ndaj pacientëve dhe të reduktoj atë në nivelin më të ultë të mundshëm.
- Të mbroj dhe mbështet shëndetin e pacientit.
- Të ruaj dhe ngrit reputacionin e mirë të profesionit të infermierit.

### Neni 3

#### Raporti ndaj pacientit

Infermierët, Mamtë dhe Profesionistet e tjerë Shëndetësor duhet që:

- Të krijojnë raporte të drejta dhe korrekte me pacientët dhe familjarët e tyre duke shfrytëzuar promovimin e shëndetit, edukimin shëndetësor dhe të gjitha format e mundshme për të përhapur dhe ofruar shërbime sa më cilësore shëndetësore.
- Kujdeset infermiore të dhëna kundrejt pacientve të jenë në vazhdimësi, plotësisht efikase, dhe korrekte, pra të kenë të dhëna të sakta se kush janë pacientët e tij/saj që arrihet përmes kartelave identifikuese, t'iu jep atyre përgjigje kur ata kanë nevojë, t'iu siguroj kushte të mira higjienike, t'i njoftoj ata edhe me personelin ,respektivisht profesionistët të tjerë shëndetësor .
- Të respektojnë intimitetin dhe sekretin profesional si një përgjigje korrekte ndaj besimit të ndërsjellët që krijohet mes tyre dhe pacientëve apo edhe familjarëve, si dhe të angazhohen për kushte sa më të mira për pacientin duke i përshtatur ato edhe me gjendjen psike - fizike të pacientit, rregullat apo zakonet e tij/saj, si dhe duke respektuar edhe pikëpamjet etnike apo të besimit fetar.
- Kursesi mos të marrin pjesë në asnjë mënyrë në përshpejtimin e vdekjes edhe nëse kur një kërkesë e tillë vjen nga vetë pacienti ose edhe nga familjari apo ndonje i afërm.

- Të kenë raporte partneriteti mes Infermierit dhe pacientit që d.m.th ofrimi i shërbimeve korrekte shëndetësore dhe marrja e atyre shërbimeve shëndetësore, duke respektuar njëri tjetrin, dhe për një shërbim efikas dhe duhet kontribuar dy palët infermierët dhe pacientët apo familjarët e tyre.

#### **Neni 4**

##### **Bashkepunimi me ekipin**

Infermierët duhet të bashkëpunojnë me kolegët e tyre dhe me profesionistët e tjerë të ekipit, për përkrahje të një ambient shëndetësor, ku aty mundësohet praktikimi më i siguritë, kompetent dhe moral për përkujdesje dhe mirëqenie të pacientëve /klientëve dhe të tjerëve në këtë mjedis, bazuar në përgjegjësitë dhe në akordim të plotë me rolin e tyre si profesionistë shëndetësor.

Infermierët, shkathësitë dhe dituritë e tyre i ndajnë me anëtarët tjerë të ekipit, në mënyrë që të përfitojnë edhe profesionistët, por më së shumti të përfitojnë pacientët/klientët dhe popullata në përgjithësi.

Infermierët mbështesin kolegët e tyre kur veprojnë me besnikëri në mbrojtje të pacientëve/klientëve.

#### **Neni 5**

##### **Fshehtësia profesionale**

Infermierja /i obligohet të ruaj të gjitha të dhënat lidhur me pacientin të cilat i ka marrë gjatë ofrimit të kujdesit shëndetësor.

Ruajtja e sekretit profesional për infermierien është detyrë morale dhe ligjore. Dhënia e fshehtësisë profesionale / bartja e fshehtësisë është e lejuar në rrethanat e caktuara vetëm brenda një ekipi të punëtorëve shëndetësor dhe konsiderohet si sekret i ndarë.

Infermieria është e detyruar të intervenoj në qoftë se pjesëmarrësit e tjerë të ekipit të kujdesit shëndetësor, nuk respektojnë detyrimin e sekretit profesional.

Infermierja është e liruar nga sekretit profesional kur një personi tjetër i rrezikohet shëndeti, kur është me interes të përgjithshëm për shëndetin e komunitetit dhe atëherë kur autoritetet kompetente marrin një vendim të tillë .

## **Neni 6**

### **Edukimi i vazhedushem**

Infermierët, Mamit dhe Profesionistët tjerë Shëndetësor pjesëtarë të Odës së Infermierëve të Kosovës duhet të mbajnë njohurit e aftësimin bashkëkohor gjatë tërë jetës në punën e tyre.

Infermieret për të punuar duhet të kenë aftësi , njohuri të nevojshme dhe aftësi efektive për funksionimin sa me efektiv të punës së tyre.

Infermieret duhet të përcaktojnë qartazi kufijtë e kompetencës(mundësis ) së tyre profesionale, qe të punojnë dhe të pranojnë përgjegjësinë për veprimtarin në të cilën janë të kualifikuar.

Në qoftëse një procedurë e cila nuk është në shkallën e kompetencës së infermierëve apo jashtë fushëveprimit të saj, ka për të kërkuar ndihmë dhe mbikëqyrjen e profesionistëve kompetent dhe nuk duhet të zbatohet një procedurë të tillë në qoftëse mund të dëmtoj drejtpërdrejtë ose tërthorazi pacientin. Infermierët kanë detyrim për të ndihmuar studentët e infermierisë dhe mamive në punën e tyre praktike.

## **Neni 7**

### **Reputacioni i Infermiereve, Mamive, dhe Profesionistve të tjerë Shëndetësor**

Infermierët, Mamitë dhe Profesionistët tjerë Shëndetësor duhet të veprojnë drejt normës profesionale në mënyrë që të rrisin reputacionin e profesionit të tyre.

Infermierët, Mamitë dhe Profesionistët tjerë Shëndetësor nuk duhet të përdorin statusin e tyre për të promovuar produkte komerciale me qëllim të përfitimit material. Ata nuk mund të lejojnë që asnjë interes të ndikoj në gjykimin e tyre profesional.

Infermierët, Mamitë dhe Profesionistët tjerë Shëndetësor duhet të refuzojnë çdo dhuratë apo favor që mund të interpretohet si një përpjekje për të marrë përfitime personale.

Infermierët nuk guxojnë të kërkojnë apo të pranojnë të holla nga pacientët apo nga të afërmit e tyre.

## Neni 8

### Mbrojtja e pacientit nga rreziqet

Infermierët, Mamitë dhe Profesionistët tjerë Shëndetësor, duhet të punojnë për zhvillimin e kujdesit infermior me ekipet e tjera, të cilët kanë përparësi sigurinë dhe shëndetin e pacientit.

Në situatat ku kërkohen standardet profesionale, dhe nuk mund të evitohen pasojat, infermierët, mamitë dhe profesionistët tjerë shëndetësor, duhet të njoftojnë personin përgjegjës me raport me shkrim.

Infermierja/i, mamia kryesore apo udhëheqësi i ekipit shëndetësor, ka përgjegjësi të veçantë ndaj kolegeve dhe pacientëve. Nëse ballafaqohen me dilemat profesionale, obligohet të konsultohet me organet përkatëse të OIK-ut, duke pasur parasysh gjithmonë në rendin e parë duhet të jetë interesi dhe siguria e pacientit.

Në rastet emergjente si në punë edhe jashtë orarit të punës, infermieri, mamia apo edhe profesionistët e tjerë shëndetësor e kanë për obligim profesional të ofrojnë ndihmën e parë duke llogaritur në kompetencat personale.

## Neni 9

### Përgjegjësia Etike

Në qoftëse një infermier nuk është i sigurt se situata e përcaktuar nuk është në përputhje me këtë kod etik atëherë duhet të konsultohet me organet përkatëse të OIK-ut.

Një infermiere e cila vënë re se kolegia e saj shkel parimet Etike të sjelljes profesionale duhet të lajmëroj organet kompetente të OIK-ut.

Infermieret nuk do të bëjnë kërkesa që kanë për qëllim të dëmtojnë ose për të fyer dikë.

Infermieret bashkëpunojnë me organet e OIK

## Neni 10

### Raporti në mes të Infermirëve

Infermierët apo profesionistët tjerë shëndetësor duhet të bashkëpunojnë me kolegët e tyre dhe të sillen ndaj tyre ashtu siç do të donin që ata të sillen ndaj saj\tij.

Infermierët dhe profesionistët të tjerë shëndetësor duhet të kujdesen për dinjitetin e tyre dhe të kolegëve nëpërmjet sjelljeve të cilat shprehin respekt dhe solidaritet gjatë kurimit dhe kujdesit infermior.

Infermierët apo profesionistët tjerë shëndetësor duhet të shprehin falënderimin ndaj mësuesve- atyre që ua mësuan dituritë dhe shkathtësitë profesionale.

## Neni 11

### Qasja /Lidhja/raporti me OIK-un

Infermierja, Mamia dhe Profesionistet tjerë Shëndetësor, OIK-un e konsideron bazë profesionale,mendimin e secilit se a mundet me promovuar reputacionin e tij -saj si në profesion ashtu dhe në publikun e gjerë.

Infermierja, Mamia dhe Profesionistet tjerë Shëndetësor,janë të e obliguar të respektojnë të gjitha aktet e përgjithshme dhe vendimet dhe udhëzimet e tjera të OIK-ut dhe të përmbushë të gjitha detyrimet ndaj odës.

## Neni 12

### Dispozitat perfundimtare

Respektimi i dispozitave te këtij kodi janë të detyrueshëm për të gjithë anëtarët e OIK-ut.

Dispozitat e këtij kodi janë obligim për të gjithë infermierët, mamitë dhe profesionistet tjerë shëndetësor. Lëndimet dhe sanksionet për shkelje të këtij kodi do të përcaktohen me akt të përgjithshëm të Odës.

Infermieret, Mamitë dhe Profesionistet të tjerë Shëndetësor janë të detyruar të refuzojëne çdo veprimtari profesionale që është në kundërshtim me këtë kod. Ndërsa Oda është e obliguar që të ju ndihmoj përmes reputacionit të saj dhe mjeteve ligjore nëse lind nevoja për këtë.

Ky Kod Etik hyn në fuqi me rastin e miratimit nga anëtarët e Kuvendit të OIK . 12.06. 2015 .